REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 29.09.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

1. Projekti I shkollës Gjergj Kastrioti është dorëzuar pranë Bashkisë Durrës,fondi I parashikuar për zbatim është miratuar në buxhetin e Bashkisë Durrës dhe jemi në fazën e procedurës së prokurimit për zbatimin e këtij projekti.

2. Në lidhje me dy pallatetet, në lagjen nr 1, zona e Currilave, në vijim të kërkesës së Bashkisë Durrës drejtuar institucioneve përkatëse, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë, Mbrojtjes Civile, Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile me shkresën nr.3264/21 prot datë 23.09.2026 dhe nr.3264/20 prot datë 23.09.2026 ka përcjellë pranë Drejtorisë së Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, dokumentacionin si më poshtë:

   - Akt ekspertizën e Vlerësimit të Aftësisë Mbajtëse Strukturore të ndërtesës ekzistuese për objektin pallati kod gis 25313, lagja nr.1, rruga “Currila” Bashkia Durrës.
   - Studimin inxhiniero sizmologjik mbi modelin gjeofizik të sheshit të ndërtimit për projektin “Studim I lëvizjes shpatore me qëllim mbrotjjen e zonës së ndodhur në objektin kod gis 25313, të ndodhur në lagjen nr.1, rruga “Currilave”, nr.22, Bashkia Durrës”.
   - Projekti i ndërhyrjeve përforcimi I shpatit kodrinor, lagja nr.1, rruga “Currilave” nr.22, Bashkia Durrës.
   - Preventivin.

- Raport projekt zatimi të projektit “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes në shatpin në zonën e Currilave, Durrës”.

Në përputhje me dokumentacionin e mësipërm Bashkia Durrës ka aplikuar për fond pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

3. Në lidhje me projektin TID, shfuqizimi i PDyV-së (Zona 5) me VKM-në nr. 621, datë 30.7.2026 nuk cenon dhe nuk anulon pasojat e ndikimit pozitiv që do të ketë Projekti TID për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e biznesit dhe turizmit në qytetin e Durrësit. Gjithashtu Projekti TID synon të krijojë një model zone të zhvillimit të biznesit/turizmit (BID), i cili në periudhën afatgjatë do të ndihmojë në përmirësimin e ofertës turistike, shërbimeve dhe promovimit të Zonës së Projektit, duke sjellë kështu zhvillim ekonomik për Zonën e Projektit dhe qytetin e Durrësit në tërësi.Bashkia Durrës po vlerëson mundësinë për vijimin e procedurave për hartimin dhe miratimin e një Plani të Detajuar Vendor (Plan Pikësor), në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, VKM nr. 408/2015, Ligjin nr. 139/2015, VKM-në nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore” i ndryshuar si dhe VKM-në nr.686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, me qëllim zhvillimin e rregullt të territorit, respektimin e të drejtave të pronësisë dhe realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Aktualisht, në kuadër të procesit të rishikimit dhe vlerësimit të projektit, po verifikohet gjithashtu nëse brenda zonës së ndërhyrjes ndodhen monumente kulture apo pasuri të tjera kulturore që gëzojnë status mbrojtjeje. Për këtë qëllim, është ngritur një grup ndërinstitucional, nga i cili pritet informacioni dhe vlerësimi përkatës lidhur me monumentet historike, pasuritë kulturore dhe elementët e trashëgimisë kulturore që mund të ndodhen brenda zonës së ndërhyrjes.
Në kuadër të këtij procesi janë zhvilluar takime në nivel institucional, përfshirë takime me Kryeministrin, si dhe janë marrë në konsideratë kërkesat dhe shqetësimet e shprehura nga qytetarët, me qëllim që këto elemente të reflektohen në vlerësimin e mëtejshëm të projektit. Për çdo rast të evidentuar, ndërhyrjet do të trajtohen në përputhje me situatën aktuale urbanistike, juridike dhe faktike të zonës, legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe në koordinim me institucionet përgjegjëse.

   Bashkia Durrës e konsideron projektin TID si një projekt me rëndësi strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit dhe veçanërisht për rijetëzimin dhe zhvillimin e zonës së ndërhyrjes. Në këtë kuadër, projekti synon të krijojë kushte për rigjallërimin e zonës, rritjen e atraktivitetit të saj për qytetarët, vizitorët dhe bizneset, si dhe forcimin e rolit të Durrësit si një destinacion i rëndësishëm kulturor dhe turistik.